



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



05/ 8982 2020
09.12.2020

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114 Kapitulli V neni 67 dhe 68 ,Ligjit të Punës Nr.03/L-212 nenit 8 , Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 nenit 5 pika c, Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 nenit 10, Ligjit për Edukimin Parashkollor në Kosovë nr.03/L-52 neni 28, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm Drejtoria për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Hanit të Elezit shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në SHFMU “Ilaz Thaçi” Hani i Elezit

Titulli i vendit të punës: **Edukator/e**

Institucioni: **Komuna Hani i Elezit**

Departamenti/Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Lloji I pozitës: **nëpunës i Shërbimit Publik**

Numri I Pozitave: **një (1)**

Titulli I mbikëqyrësit: **Drejtori i Shkollës**

Grada/Koeficienti: **Koeficienti A-393/1**

Orët e punës: **40**

Kohëzgjatja e emërimit: **me kohë të pacaktuar**

Detyrat dhe përgjegjësitë për Edukator/e :

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimor dhe edukativ;
- Përdor metoda dhe teknika bashkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Harton plane individuale për nxënësit;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme të aftë, që të krijoj mardhënie me të tjerët;
- Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Duhet të jenë të motivuara që të punojnë me fëmijë;
- Kryen punë tjera që i cakton drejtori i shkollës;

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

Fakulteti i Edukimit-programi parashkollor;

Shkolla e Lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatore;

Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme;

Fakulteti i Shkencave Sociale-programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve;

Dokumentet e nevojshme:

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
Rezymeja personale (CV).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).

Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.

Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i, tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 08.01.2021 deri 22.01.2021 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe në për kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe në tabelën e shpalljes.



Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Menduh Vlasi